



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 21. 09. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Nerxhivane Dauti, Danush Ademi, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Drita Maliqi, Luljeta Shehu, Ibrahim Selmanaj dhe Shpresa Murati.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi - OSEB dhe Besnik Ramadani – KDI.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7. 09. 2010,
3. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit funksional në Projektligjin për Energjinë, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
4. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për shqyrtimin e vlerësimit strategjik mjedisor, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për prokurorin e shtetit, nga aspekti i të drejtave të njeriut.
6. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,

- 7 Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
- 8 Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut.
- 9 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 10 Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Në mungesë të amendamenteve të proceduara Komisioni u pajtua të hiqen nga rendi i ditës pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, sepse Komisioni Funksional nuk ka arritur t'i përfundojë dhe t'i sjellë për shqyrtim. Gjithashtu Komisioni u pajtua që në pikën të ndryshme të shqyrtohen:

- a) Amendamentet e Komisionit Funksional në Projektligjin për dokumentet e udhëtimit, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
- b) Projektligjit për personat e zhdukur.

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07. 09. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejte procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 07.09.2010.

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit dhe u dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e Komisionit. Tha se vërejtja për heqjen e projektligjeve nga shqyrtimi është me vend, prandaj kërkoi nga administrata të sqarohet pse nuk është dorëzuar materiali.

Rrahim Demaj - koordinator – Koordinatorët e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural kanë kërkuar që këto amendamente të përfshihen në agjendë, sepse sipas tyre këto projektligje do të jenë në lexim të dytë, por komisionet nuk kanë arritur t'i përfundojnë, nuk na është proceduar materiali as nuk jemi njoftuar pse nuk është proceduar.

Kryetari - Propozoi të shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit.

9. Shqyrtimi i disa peticioneve

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses tha se i ka shqyrtuar kërkesën e M. Prekpalajt, nga Zymi i Hasit dhe atë të Sindikatës së Pavarur NBI nga Suhareka, për të cilat Komisionit ofroi zgjidhje.

Komisioni e mbështeti mendimin e saj lidhur me ofrimin e zgjidhjes dhe vendosi të njoftohen palët për rekomandimet përkatëse.

10. Të ndryshme

Shqyrtimi i Projektligjit për persona të zhdukur

Fatmir Rexhepi – Foli për rëndësinë e Projektligjit për persona të zhdukur. Propozoi që në bazë të nenit 62, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktohet grupi i punës për amendamentimin e Projektligjit për persona të zhdukur.

Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të formohet grupi i punës me këtë përbërje:

1. *Ibrahim Makolli, kryetar,*
2. *Ibrahim Selmanaj, anëtar,*
3. *Luljeta Shehu, anëtare dhe*
4. *Hajredin Hyseni, anëtar.*

II. Komisioni do të njoftohet nga grupi i punës me shkrim për përmbajtjen e amendamenteve në Projektligjin për persona të zhdukur, që do ta miratojë.

Rreth punëve të grupit të punës që do të merret me shqyrtimin e Projektligjit diskutuan deputetët: Ibrahim Makolli, Drita Maliqi, Luljeta Shehu – anëtarë. Konstatim i përgjithshëm ishte që për shqyrtimin e Projektligjit të ftohen të gjithë aktorët e interesuar që e zbatojnë ligjin. Po ashtu u kërkuar të gjenden ekspertë dhe të respektohet afati sipas Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mbledhja e radhës u caktua të mbahet më 27 shtator.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi